



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE
-Këshilli Drejtues-

V E N D I M

Nr.747, datë 17. 07. 2009

Për miratimin e dokumentit rregullator “Rregullore për analizën e tregut”

Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), i përbërë nga:

- | | | |
|----------------|--------|---------|
| 1. Z. Ilir | Shehu | Kryetar |
| 2. Z. Afrim | Tonuzi | Anëtar |
| 3. Znj. Edlira | Kasaj | Anëtar |
| 4. Z. Ilir | Zela | Anëtar |
| 5. Z. Jetmir | Karini | Anëtar |

dhe sekretare të Këshillit Drejtues Znj. Marsida Dushku, në mbledhjen e datës 17. 07. 2009, sipas procedurës së përcaktuar në nenin 7 e në vijim të Rregullores së Brendshme të AKEP, mori në shqyrtim dokumentacionin e paraqitur nga grupi i punës për miratimin e dokumentit rregullator “Rregullore për analizën e tregut”.

BAZA LIGJORE:

1. Gërma p) e nenit 8, neni 31, 32, 34 dhe neni 110 i ligjit nr. 9918, datë 19. 05. 2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë” (*ligji nr. 9918*);
2. Nenet 1, 2, 106 e në vijim të ligjit nr. 8485, datë 12.05.1999 “Kodi i Procedurave Administrative” (*ligji nr. 8485*), i ndryshuar;
3. Pika 17 e nenit 21 “Rregullores së Brendëshme të AKEP (ish ERT)” (*Rregullorja e Brendshme*), miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues (VKD) të ERT-së, Nr. 170, datë 24. 04. 2004, e ndryshuar dhe në fuqi sipas pikës 3 të nenit 138 të ligjit nr. 9918;

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur si dhe duke iu referuar bazës ligjore të sipërcituar :

V Ë R E H E T se :

1. Dokumentacioni i paraqitur nga grupi i punës për miratim përbëhet nga:
 - Projektvendimi i KD i formatuar dhe arsyetuar sipas përcaktimeve të parashikuara në nenin 106 e në vijim të ligjit nr. 8485;
 - Dokumenti rregullator “Rregullore për Analizën e Tregut” – versioni final;
 - Relacioni shpjegues për Projektvendimin e KD;
 - Informacioni shkresor lidhur me komentet e palëve të interesuara gjatë procesit të konsultimit publik për dokumentin rregullator “Rregullore për analizën e tregut” dhe qëndrimin e grupit të punës mbi këto komente.
2. Dokumenti rregullator “Rregullore për analizën e tregut” i hartuar nga grupi i punës sipas Urdhërit të Brendshëm nr. 3053/1 Prot., datë 10. 11. 2008 “Për ngritjen e grupit të punës për hartimin e draft-rregullores “Për Analizën e Tregut”, i përbërë nga:
 - Altin Rrapaj - Kryetar;
 - Rudolf Papa - Anëtar;
 - Nuredin Hasanaj - Anëtar;
 - Elizaveta Treska - Anëtar,

në zbatim të Vendimit Nr.517, datë 11. 12. 2008 të KD të AKEP “Për miratimin e dokumentit rregullator për këshillim publik “Projekt-rregullore për analizën e tregut” dhe në përputhje me procedurën e përcaktuar në nenin 110 të ligjit nr. 9918, u hodh për konsultim publik më datë 12. 12. 2008.

3. Gjatë procesit të konsultimit publik për dokumentin rregullator “Projekt-rregullore për analizën e tregut”, kanë paraqitur komentet e tyre palët e interesuara:
 - Vodafone Albania Sh.a.;
 - Albanian Mobile Communications (AMC) Sh.a.;
 - Abcom Sh.a.;
 - Autoriteti i Konkurrencës,
 të cilat janë bërë pjesë e praktikës dokumentare të paraqitur nga grupi i punës për miratim.
4. Grupi i punës, mbi komentet e palëve të interesuara për dokumentin rregullator gjatë procesit të konsultimit publik ka parashtruar qëndrimin e tij të arsyetuar duke e bërë pjesë të praktikës dokumentare të paraqitur për miratim. Konkluzionet e grupit të punës janë pasqyruar në versionin final të dokumentit rregullator “Rregullore për analizën e tregut”.

PERFUNDIMISHT,

Këshilli Drejtues i AKEP, duke çmuar se:

1. Dokumentacioni i paraqitur me shkresën nr. 1379 prot., datë 13. 03. 2009 nga grupi i punës, për miratimin e dokumentit rregullator “Rregullore për analizën e tregut” nga pikpamja formale është në konformitet me kërkesat e përcaktuara në nenin 10/1 të Rregullores së Brendshme.

2. Procedura e konsultimit publik për dokumentin rregullator “Rregullore për analizën e tregut” është kryer në përputhje me përcaktimet e parashikuara në nenin 110 të ligjit nr. 9918.
3. Qëndrimi i parashtruar nga grupi i punës mbi komentet e paraqitura nga palët e interesuara gjatë procesit të këshillimit publik për dokumentin rregullator është i drejt, i rregullt dhe në përputhje me kërkesat ligjore të përcaktuara në nenin 31 e në vijim të ligjit nr. 9918.
4. Versioni final i dokumentit rregullator “Rregullore për analizën e tregut” reflekton konkluzionet e grupit të punës bazuar në qëndrimin e mbajtur mbi komentet e bëra nga palët e interesuara gjatë procesit të konsultimit publik dhe përmbush qëllimet e AKEP-it për realizimin e objektivave rregullore sipas nenit 7 të ligjit nr. 9918.

ATEHERE:

Për sa më sipër si dhe duke patur parasysh se dokumenti rregullator “ Rregullator për analizën e tregjeve” si një dokument rregullator shumë i rëndësishëm dhe me ndikim të ndjeshëm në tregun e komunikimeve elektronike është hartuar në bashkëpunim me konsulentin e projektit të EBRD (Projekti i Zhvillimit dhe Rregullimit të Komunikacioneve), KD i AKEP bazuar në pikën 17 të nenit 21 të Rregullores së Brendëshme,

V E N D O S I :

1. Miratimin e “Rregullore për Analizën e Tregut” -të paraqitur nga grupi i punës, dhe me ndryshimet e reflektuara gjatë diskutimit në mbledhje, me përmbajtjen sipas dokumentit bashkëlidhur këtij vendimi (Lidhja 1).
2. Miratimin e dokumentit, “Komentet e paleve të interesuara për draft Rregulloren e Analizes së Tregut dhe qëndrimi i AKEP për keto komente”, të paraqitur nga grupi i punës me ndryshimet e reflektuara gjatë diskutimit në mbledhje (Lidhja 2).

Ky vendim hyn në fuqi në fuqi menjehere.

KRYETAR I KËSHILLIT DREJTUES Ilir SHEHU

Anëtarë të Këshillit Drejtues:

1. Afrim TONUZI
2. Edlira KASAJ
3. Ilir ZELA
4. Jetmir KARINI

Rregullorja per Analizen e Tregut

Neni 1

Objekti

Kjo rregullore percakton menyren e zbatimit te procesit te perkufizimeve te tregut dhe analizave te tregut ne perputhje me nenet 31 – 39 te Ligjit 9918,te dt. 19.05.2008 “Mbi Komunikimet Elektronike ne Republiken e Shqiperise”.

Neni 2

Metodologjia

1. AKEP rregullisht:
 - a) percakton tregjet te justifikuara per nderhyrje ex ante ne perputhje me nenin 32 te Ligjit 9918,
 - b) vlereson sipermarresit me fuqi te ndjeshme ne keto tregje ne perputhje me nenin 33 te ligjit 9918,dhe
 - c) vendos, mban, ndryshon ose anulon detyrimet rregullatore te specifikuara ne nenet 39, 40, 41, 42, 43, 44, 45 dhe 56 te ligjit 9918, ne perputhje me nenin 34 te ligjit 9918.
2. Gjate zbatimit te procedurave te pershkruara ne piken 1 te ketij neni, AKEP merr ne konsiderate edhe direktivat/udhezimet/rekomandimet e Bashkimit European mbi analizat e tregjeve dhe vleresimin e FNT sipas kuadrit rregullator te Komunitetit European per rrjetet dhe sherbimet e komunikimeve elektronike.
3. AKEP u kerkon sipermarresve te cilet ofrojne sherbime dhe rrjete te komunikimeve elektronike, te paraqesin te dhenat te cilat kerkohen per te percaktuar dhe analizuar tregjet ne perputhje me nenin 16 te ligjit 9918.Ne keto kerkesa AKEP do te percaktoje formatin ne te cilin te dhenat e kerkuara do te paraqiten si dhe do te vendose afatin kohor per dorezimin e tyre. Siperrmarresit qe ofrojne rrjete dhe sherbime te komunikimeve elektronike jane te detyruar te paraqesin te dhenat ne formatin e kerkuar dhe brenda afati te kerkuar.

Neni 3

Lista e tregjeve perkatese

1. AKEP analizon per FNT tregjet perkatese te meposhteme si tregje te mundshme per nderhyrje ex-ante ne territorin e Republikes se Shqiperise ne fushen e komunikimeve elektronike:
 - 1) Tregun me pakice te aksesit ne rrjet telefonik publik nga vendodhje fikse per klientet familjare;
 - 2) Tregun me pakice te aksesit ne rrjet telefonik publik nga vendodhje fikse per klientet jo-familjare;
 - 3) Tregun me pakice per sherbimet lokale dhe/ose kombetare te disponueshme per publikun te ofruar nga vendodhje fikse per klientet familjare.
 - 4) Tregun me pakice per sherbimet telefonike nderkombetare te disponueshme per publikun te ofruara nga vendodhje fikse per klientet familjare.

- 5) Tregun me pakice per sherbimet lokale dhe/ose kombetare te disponueshme per publikun te ofruar nga vendodhje fikse per klientet jo-familjare.
 - 6) Tregun me pakice per sherbimet nderkombetare te disponueshme per publikun te ofruara nga vendodhje fikse per klientet jo-familjare.
 - 7) Tregun me pakice te minimumit te linjave me qera (i cili perfshin lloje te specifikuar te linjave me qira deri ne dhe perfshire 2Mb/sek)
 - 8) Tregun me pakice te aksesit dhe sherbimeve nepermjet rrjeteve mobile.
 - 9) Tregun me shumice te origjinimit te thirrjeve ne rrjetin telefonik publik te ofruara nga vendodhje fikse .
 - 10) Tregun me shumice te terminimit te thirrjeve per rrjete publike telefonike individuale te ofruara nga vendodhje fikse
 - 11) Tregun me shumice te sherbimeve transite ne rrjetet telefonike publike fikse.
 - 12) Tregun me shumice te segmenteve terminuese te linjave me qera.
 - 13) Tregun me shumice te linjave kryesore (trunk) te linjave me qera.
 - 14) Tregun me shumice te aksesit ne infrastrukturen e rrjeteve fizike (perfshire aksesin e ndare te pjesshem ose te plote) nga vendodhje fikse.
 - 15) Tregun me shumice te aksesit broadband .
 - 16) Tregun me shumice te aksesit dhe origjinimin e thirrjeve ne rrjetet telefonike publike te levizshme
 - 17) Tregun me shumice te terminimit te thirrjeve ne rrjetet individuale te levizshme.
 - 18) Tregun kombetar me shumice per roamingun Nderkombetar ne rrjetet publike te levizshme.
2. AKEP mund te percaktoje dhe analizoje tregje te tjera qe nuk jane pjese e listes ne piken 1, te ketij neni.
 3. Perkufizimi i detajuar i tregjeve perkatese, dimensionimi gjeografik dhe i produktit/sherbimit, do te jene pjese e dokumentit te analizes se tregut.
 4. Nese nje treg i analizuar nga AKEP nuk eshte pjese e listes se Rekomandimit te KE te dates 11 Shkurt 2003 (2003/311/EC), atehere AKEP vlereson gjithashtu nese ky treg ploteson tre kriteret e meposhteme :
 - I. prezenca e barrierave te larta dhe jo-kalimtare te hyrjes ;
 - II. nje strukture tregu e cila nuk ka tendence per te shkuar ne drejtimin te nje konkurrence efektive brenda afatit kohor perkates; dhe
 - III. pamajftueshmeria e ligjit te konkurrences per te adresuar ne menyre te pershtatshme deshtimin e tregut te marre ne shqyrtim
5. Nqs AKEP gjate analizimit dhe percaktimit te nje tregu qe nuk eshte pjese e listes se Rekomandimit te KE te dates 11 Shkurt 2003 (2003/311/EC), arrin ne perfudimin se, ky treg nuk ploteson nje nga kriteret e referuara ne piken 4 te ketij neni, AKEP nuk e analizon kete treg per fuqi te ndjeshme ne treg dhe nuk vendos detyrime rregullatore ne kete treg ose anulon detyrimet rregullatore ekzistuese, sipas parashikimeve te Ligjit nr.9918, dt. 19.05.2008 “Mbi Komunikimet Elektronike ne Republiken e Shqiperise”.

Neni 4

Rishikimi i përcaktimit të tregut dhe analizës së tregut

Kur gjykohet se faktet, që justifikuan përfundimet e arritura për përcaktimin dhe analizën e tregjeve, kanë ndryshuar dhe nuk pasqyrojnë situatën aktuale në treg, atëherë AKEP rishikon përfundimet dhe vendimet përkatëse.

Neni 5

Hyrja ne fuqi

1. Kjo rregullore hyn ne fuqi menjehere.
2. Rregullorja per Percaktimin e Organizmave me Fuqi te Ndjeshme ne Tregun e Telekomunikacioneve, miratuar me Vendim te keshillit Drejtues te ERT, VKD nr.257, date 16.09.2005, shfuqizohet.

Komentet e paleve te interesuara per draft Rregulloren e Analizes se Tregut dhe qendrimi i AKEP per keto komente.

Ne perfundim te afatit nje-mujor te konsultimit publik, per Draft-rregulloren e Analizes se Tregut te publikuar me date 12.12.2008, nga palet e interesuara kane dhene komente:

- Vodafone Albania;
- AMC;
- Abcom, dhe
- Autoriteti i Konkurences

AKEP deshiron te falenderoje palet e intersuara per komentet e dhena. Keto komente ne forme te permbledhur paraqiten ne vijim ne seksionin I, dhe me pas ne seksionin II do te jete qendrimi i AKEP per keto komente.

I. Komentet e paleve te interesuara per draft Rregulloren e Analizes se Tregut

Komentet e Vodafone Albania

Vodafone Albania (ne vijim referuara Vodafone) ka derguar komentet per draft rregulloren, me shkresen Ref.CEO/0002/EXH, date 12.01.2009. Nepermjet shkreses Vodafone ka dhene disa komente te pergjithshme dhe me pas vijon me komente te detajuara per draft rregulloren, te cilat ndahen ne 4 grupe kryesore.

1. Vodafone argumenton se AKEP nuk duhet te perdore njekohesisht rekomandimet e BE te vitit 2003 dhe ato te 2007. Rekomandimi i Komisionit, datë 11 shkurt 2003 (2003/311/EC, OJ L 114, 8.5.2003, p. 45) eshte zevendesuar me Rekomandimin e Komisionit, datë 17 dhjetor 2007 (2007/879/EC, OJ L 344, 28.12.2007, p. 65). Vodafone sugjeron te perdoret Rekomandimi vitit 2007, rekomandim ky i cili eshte aktualisht ne fuqi dhe sugjerohet dhe ne Nenet 31 dhe 32 te Ligjit te ri.
2. Ne vijim te nenit 3 te Draft Rregullores, ku AKEP ka percaktuar nje liste prej 18 tregjesh brenda sektorit te telekomunikacioneve, Vodafone komenton se:
 - a. kjo eshte nje liste teper e gjate pasi dhe vete rekomandimi i KE-se te vitit 2007, percakton per analizim jo me shume se 7 tregje. Kjo liste nuk eshte ne perputhje as me rekomandimin e vitit 2007 as me rekomandimin e vitit 2002 te KE, pasi ne te perfshihen tregje shtese dhe kjo vjen ne kundërshtim me nenin 31 dhe 32 te cilat kerkojne qe rregullorja te jete ne perputhje me rekomandimet perkatese te BE.
 - b. Ne listen e tregjeve per analizim percaktohet gjithashtu tregu me pakice i aksesit dhe sherbimeve nepermjet rrjeteve mobile, treg I cili nuk rezulton ne asnje nga rekomandimet e BE dhe bie ne kundërshtim me Nenet 31 dhe 32.

- c. Nëse AKEP synon të analizojë këto treg (tregun me pakice mobile) duhet të përcaktohet kuadri ligjor mbi vendosjen e masave rregullatore në bazë të ligjit 9918. Është absurde të përcaktohet statusi i operatorëve me FNT, të përcaktohen masat rregullatore në bazë të nenëve 39 deri 45 dhe 56 të Ligjit dhe pastaj rregullimi i tarifave të përdoruesve fundorë të bëhet në bazë të akteve nenligjore të shfuqizuara. AKEP duhet të angazhohet për rishikimin e përputhshmërisë logjore të metodologjive ekzistuese sipas kërkesave të Ligjit 9918.

Vodafone konkludon për listën e 18 tregjeve se, AKEP duhet të referohet listës prej 7 tregjeve të rekomandimit të vitit 2007 të KE. Në rast se AKEP konsideron se kushte aktuale të tregut Shqiptar ndodhen në një fazë më të hershme të zhvillimit se Rekomandimi i vitit 2007, atëherë AKEP mund të drejtohet rekomandimeve të vitit 2003 të KE, por nuk mund të përfshijë në rregullim tregje të cilat nuk parashikohen në asnjë nga rregulloret e BE, ashtu sikurse është tregu me pakice i aksesit dhe shërbimeve nepërmjet rrjeteve mobile.

3. Vodafone rekomandon se në nenin 2.1/b të projekt-Rregullores fjalja “*AKEP do të vlerësojë fuqinë e tregut të katër tregjeve në përputhje me nenin 33 të Ligjit 9918*” të saktësohet në “*AKEP do të vlerësojë fuqinë e tregut të operatorëve që veprojnë në këto tregje në përputhje me nenin 33 të Ligjit 9918*”
4. Vodafone komenton në lidhje me aplikimin e testit të 3 kritereve për listën e tregjeve të përcaktuara në nenin 3 të draft rregullores. Në bazë të dokumentit për keshillim publik, vërehet qartë se testi i 3 kritereve është përmbushur për listën e 18 tregjeve, dhe kjo gjë nënkupton se AKEP paragjykon sistuatën. Përfshirja në listë e 18 tregjeve duhet të bëhet pas një analize paraprake të AKEP, si dhe një konsultimi me operatorët, përpara se të merren vendime. Gjithashtu Vodafone saktëson që jo detyrimsht një treg që përfshihet në listë duhet të ketë nderhyrje rregullatore. Këto të përcakton dhe rekomandimi i BE 2007.
5. Duke qenë se përcaktimi i kësaj liste tregjesh bëhet për herë të parë në Shqipëri ajo duhet të jetë patjetër produkt i një analize të thelluar dhe jo bazë e një supozimi. Nuk do të ishte aspak e dëshirueshme që analiza e tregut të paragjykohej që në momentin e perkufizimit të tregut ose me keq akoma që në momentin e përgatitjes së rregullores.

Komentet e AMC

AMC ka dërguar komentet për draft rregulloren, me shkresën Nr.Prot. 6816/1 datë 12.01.2009.

1. Lista e tregjeve nuk reflekton Direktivat e BE 2007 dhe gjithashtu kjo mangësi bie ndesh me dispozitat e Ligjit të ri, veçanërisht me nenin 31, paragrafi 4 dhe nenin 32.
2. Rekomandimet e BE listojnë vetëm 7 tregje në total, ku vetëm terminimi i thirrjeve mobile (mobile termination call) është treg që duhet përfshirë tek lista e tregjeve përkatëse, nderkohe që listoni 18 tregje duke përfshirë 4 tregje mobile.

3. AKEP duhet te siguroje qe procesi I analizes se tregut duhet te jete ne perputhje me Direktivat e BE 2007.
4. Tregjet me pakice mobie nuk shfaqen ne listen e rekomandimeve te BE 2007 dhe as ne rekomandimet e meparshme.AKEP nuk jep asnje argument dhe sqarim ne lidhje me shtimin e ketij tregu.
5. Tregu me shumice i origjinimit te thirrjeve ne rrjetet e levizshme nuk gjendet gjithashtu ne rekomandimet e BE 2007.Institucionet rregullatore te BE kane konstatuar se ky treg eshte efektiv. E njejta gje duhet zbatuar dhe ne vendin tone. Konkurrenca ne treg tashme eshte rritur ndjeshem dhe sektori i telefonise celulare eshte shume me teper konkurrues me futjen e operatorit te trete celular dhe me pergatitjen per hyrjen ne treg te operatorit te katert .
6. Terminimi I thirrjeve zanore ne rrjetat e levizshme eshte nje treg i cili perfshihet ne rekomandimet e BE.Theksojme qe rregullimi duhet te jete mbi terminimin e thirrjeve zanore Kombetare.
7. Tregu Kombetar me shumice per roamingun Nderkombetar ne rrjetat publike te levizshme eshte hequr nga lista e tregjeve te Komisionit European ,sepse ai eshte subjekt i nje rregullimi special ne te gjithe E-ne. Ky rregullim special prek 2 tregje, ate Kombetar me shumice per roamingun Nderkombetar dhe tregun Nderkombetar me shumice per abonentet te secilit vend. Rregullimi i imponuar ne vendet e BE-se solli qe vendet jashe BE-se te perballen me kosto me te larta se vendet brenda BE-se. Rregullimi ne kete rast duhet te jete i dyanshem pa asnje lloj diskriminimi. Perderisa Shqiperia nuk eshte pjese e BE-se dhe s'mund te kete ndikim ne tregjet me shumice te roamingut Nderkombetar, atehere ky rregullim eshte I pamundur dhe nuk sjell asnje perfitim,gjithashtu ky treg nuk duhet te jete pjese e listes.
8. Nese AKEP deshiron te shtojte tregje jashte aneksit te Direktives se KE-se te vitit 2007, AKEP duhet ti shtojte keto tregje vetem pas aplikimit te testit te 3 kritereve. Cdo veprim i kundert do te paragjykonte paanshmerine dhe cilesine e analizes se tregjeve te telefonise se levizshme.

ABCOM

ABCOM ka derguar komentet per draft rregulloren, me shkresen nr.prot. 7. date 13.01.2009. Nepermjet shkreses, ABCOM ka dhene nje veshtrim te pergjithshem te dokumentit per keshillim publik dhe me pas sugjeron te behen sakesime ne nenin 2, pika 1/b dhe neni 3 pika e dyte, si ne vijim:

- pamjaftueshmeria e ligjit te konkurrences per te adresuar ne menyre te pershtatshme deshtimin e tregut

- te vleresoje sipermarresit me fuqi te ndjeshme ne keto tregje ne perputhje me nenin 33 te Ligjit 9918"

II. Qendrimi i AKEP per Komentet e paleve te interesuara per Draft Rregulloren e Analizes se Tregut

AKEP, pasi shqyrtoi komentetet e dhena nga palet e interesuara, dhe duke rivleresuar draft rregulloren dhe dokumentin shoqerues te publikuar me 12.12.2008, ve re ,se ka nje kunderthenie ne lidhje me perdorimin e testit te 3 kriterëve.

Sipas dokumentit shoqerues te draft rregullore me 12 .12.2008, ky test do te kryhej vetem per tregjet te cilat nuk ishin pjese e listes se 18 tregjeve.

Rregullat në shtojcën A të këtij dokumenti supozojnë se për listën e tregjeve në nenin 3, pika 1, të draftit, tri kriteret janë përmbushur. Neni 3 pika 2 e draftit parashikon se AKEP-i mund të përcaktojë dhe analizojë tregje të tjera përveç atyre të përfshira në listë pas aplikimit të testit të 3 kriterëve.

Nderkohe sipas pikes 3 te nenit 3 te Draft Rregullores te propozuar e 12.12.2008:

Nqs AKEP gjate analizimit dhe percaktimit te nje nga tregjeve te permendura ne piken 1 te ketij neni vendos, qe ky treg nuk ploteson nje nga kriteret ne piken 2 te ketij neni ,AKEP nuk do te vendose detyrime rregullatore ne kete treg ose do te anulloje detyrimet rregullatore ekzistuese

nenkuptohet se testi i 3 kriterëve do te aplikohet per te 18 tregjet gjate analizes se tyre, dhe ne rast te mosplotesimit te nje prej 3 kriterëve nuk do te vendose detyrime rregullatore ne kete treg ose do te anulloje detyrimet rregullatore ekzistuese

AKEP per te shmangur kete kunderthenie gjykon te arsyeshem te beje modifikime te rregullores, duke vendosur qe te aplikojë testin e 3 kriterëve, vetem per tregjet qe nuk jane pjese e listes se Aneksit te Rekomandimit te KE te dates 11 Shkurt 2003 (2003/311/EC). Ky modifikim e ben rregulloren te jete ne linje me rekomandimin e vitit 2003 te KE.

AKEP, pasi shqyrtoi komentetet e dhena nga palet e interesuara dhe duke rivlersuar Draft Rregulloren per aplikimin e testit te 3 kriterëve, jep keto qendrime per komentet e paleve te interesuara:

- ne lidhje me komentet per listen e 18 tregjeve, ne piken 1 te nenit 3: referenca per Rekomandimin e KE te vitit 2003 apo te vitit 2007

AKEP ne hatimin e listes se nenit 3, ka marre ne konsiderate listen ne aneksit e rekomandimit te KE te vitit 2003 duke shtuar tregun me pakice te telefonise celulare, pasi konsideron se hartimi i listes ne perputhje me rekomandimin e vitit 2007, nuk i pergjigjet kushteve reale te tregut Shqiptar, sic shprehet edhe vete Vodafone, dhe reflektimi i *kushteve aktuale te tregut Shqiptar* eshte parashikuar te merret ne konsiderate edhe ne nenin 32 te Ligjit 9918. Per sa me siper AKEP eshte bazuar qe si pike fillestare per hartimin e listes se tregjeve te marre ne konsiderate rekomandimin e vitit 2003, i cili megjithese eshte zevendesuar me rekomandimin 2007, eshte me afer kushteve aktuale te tregut Shqiptar. Ne kete sens jane perfshire ne liste edhe tregjet (celulare) qe nuk jane pjese e rekomandimit te vitit 2007 (tregjet 16 dhe 18) por pjese e rekomandimit te vitit 2003.

- Perfshirja e tregut të shërbimeve mobile me pakicë në listën e tregjeve të justifikuar (të nevojshme për të konsideruar) për nderhyrje ex – ante (tregu 8, Lista e nenit 3 pika 1)

AKEP sqaron se ky treg është përfshirë në listën e tregjeve të justifikuar (dyshuar) për nderhyrje ex – ante, megjithatë nuk është pjesë e listës së tregjeve të Rekomandimit të vitit 2003 të KE, për shkak të konkluzioneve të Analizave të Tregut të vitit 2006 dhe 2007, ku është arritur në konkluzion se ky treg nuk ishte në konkurrencë efektive, dhe për të cilin u morën masat përkatëse rregulluese. Megjithatë përfshirja e tregut mobile me pakicë, si dhe tregjet e tjera, nuk janë paragjykur nga AKEP. Perfshirja në listë nuk do të thotë që ky treg ka nevojë të rregullohet ex – ante dhe të aplikohen masa rregullatore. Pika 3 e nenit 3 të draft rregullores, sqaron se nëse AKEP aplikon testin e 3 kritereve, të pikës 2 (për çdonjerin nga tregjet e listës) dhe rezultoni se një nga kriteret nuk plotësohet, AKEP nuk do të aplikojë masa rregullatore në këtë treg dhe do të anulohet detyrimi i vena me parë. Nderkohe edhe nëse një treg plotëson të tre kriteret, ky treg do të analizohet vetëm nëse ka sipërmarres me FNT. Në rast se ky treg nuk ka sipërmarres me FNT, atëherë nuk vendosen masa rregullatore dhe hiqen ato të vendosura me parë (nëse ka).

Aplikimi i testit të 3 kritereve për tregjet e përcaktuara si të justifikuar (apo me saktë të dyshuar) për nderhyrje ex - ante

AKEP sqaron palet e intersuara se në versionin e publikuar me datë 12.12.2008, pika 3 e nenit 3 të draft rregullores,

Nqs AKEP gjatë analizimit dhe përcaktimit të një nga tregjeve të përmendura në pikën 1 të këtij neni vendos, që nqs ky treg nuk plotëson një nga kriteret në pikën 2 të këtij neni, AKEP nuk do të vendosë detyrime rregullatore në këtë treg ose do të anulohet detyrimi rregullator ekzistues.

permend mjaft qartë se AKEP do të aplikojë testin e 3 kritereve për çdo treg të listuar në pikën 1.

Në vijim të qartësimit të dhënë me sipër, për aplikimin e këtij kriteri, AKEP ka bërë modifikim të kesaj pike, duke saktësuar se testi i 3 kritereve do të aplikohet për tregjet që nuk janë në Anëksin e Rekomandimeve të vitit 2003 të KE-se.

Në vijim të komenteve të paleve të intersuara dhe qëndrimeve të AKEP të dhëna me sipër, AKEP ka vendosur të bëjë disa modifikime të draft rregullores si me poshtë vijon, modifikime të cilat janë reflektuar dhe në versionin final të Rregullores të miratuar nga AKEP):

- Neni 2, pika a dhe b. Janë ndryshuar nga:

- a) të përcaktoje tregjet të rregulluara ex ante në përputhje me nenin 32 të Ligjit 9918,
- b) të vlerësoje fuqinë e tregut të këtyre tregjeve në përputhje me nenin 33 të ligjit 9918, dhe

ne:

- a) përcakton tregjet të justifikuar për nderhyrje ex ante në përputhje me nenin 32 të Ligjit 9918,
- b) vlerëson sipërmarresit me fuqi të ndjeshme në këto tregje në përputhje me nenin 33 të ligjit 9918, dhe

- Fjalja e pare e nenit 3, ashte ndryshuar nga:

- AKEP do te percaktoje dhe analizoje tregjet perkatese te meposhteme :

ne:

- AKEP analizon per FNT tregjet perkatese te meposhteme si tregje te justifikuara per nderhyrje ex-ante ne territorin e Republikes se Shqiperise:

- Pika 2 e nenit 3 eshte zevendesuar me parashimin e meposhtem:

3.Perkufizimi i detajuar i tregjeve perkatese, dimensionin gjegrafik dhe i produktit/sherbimit, do te jene pjese e dokumentit te analizes se tregut.

- Pika 2 e nenit Neni 3 eshte perifrastuar ne piken 4 si ne vijim:

6. Nese nje treg i analizuar nga AKEP nuk eshte pjese e listes se Rekomandimit te KE te dates 11 Shkurt 2003 (2003/311/EC), atehere AKEP vlereson gjithashtu nese ky treg ploteson tre kriteret e meposhteme :

IV. prezenca e barrierave te larta dhe jo-kalimtare te hyrjes ;

V. nje strukture tregu e cila nuk ka tendence per te shkuar ne drejtimin te nje konkurrence efektive brenda afatit kohor perkates; dhe

VI. pamajftuesheria e ligjit te konkurrences per te adresuar ne menyre te pershtatshme deshtimin e tregut te marre ne shqyrtim

- Pika 3 e nenit 3, eshte ndryshuar nga:

3. Nqs AKEP gjate analizimit dhe percaktimit te nje nga tregjeve te permendura ne piken 1 te ketij neni vendos, qe ky treg nuk ploteson nje nga kriteret ne piken 2 te ketij neni ,AKEP nuk do te vendose detyrime rregullatore ne kete treg ose do te anulloje detyrimet rregullatore ekzistuese

ne:

5.Nqs AKEP gjate analizimit dhe percaktimit te nje tregu qe nuk eshte pjese e listes se Rekomandimit te KE te dates 11 Shkurt 2003 (2003/311/EC), arrin ne perfudimin se, ky treg nuk ploteson nje nga kriteret e referuara ne piken 4 te ketij neni, AKEP nuk e analizon kete treg per fuqi te ndjeshme ne treg dhe nuk vendos detyrime rregullatore ne kete treg ose anulon detyrimet rregullatore ekzistuese, sipas parashikimeve te Ligjit nr.9918, dt. 19.05.2008 “Mbi Komunikimet Elektronike ne Republikën e Shqiperise”.

Ne nenin 3, eshte shtuar pika 2, dhe eshte shtuar neni 4 si ne vijim:

7. AKEP mund te percaktoje dhe analizoje tregje te tjera qe nuk jane pjese e listes ne piken 1, te ketij neni.

Neni 4

Rishikimi i përcaktimit të tregut dhe analizës së tregut

Kur gjykohet se faktet, që justifikuan përfundimet e arritura për përcaktimin dhe analizën e tregjeve, kanë ndryshuar dhe nuk pasqyrojnë situatën aktuale në treg, atëherë AKEP rishikon përfundimet dhe vendimet përkatëse.

AKEP ka bërë dhe disa saktësime të nevojshme për lehtësimin e rrjedhësmerisë së rregullore